



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22 Prill 2023

Nr : 395

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMEVE NR. 261 ID, 262 ID, 273 ID, 274 ID, 275 ID, 276 ID, 288 ID, 289 ID, 291 ID, 292 ID, 293 ID, 296 ID, 297 ID, 298 ID, 305 ID, 307 ID, 309 ID, 310 ID, 311 ID, 312 ID, 313 ID, 315 ID, 316 ID, 317 ID, TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ PERSONAVE PËRGJEGJËS, PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 22 Prill 2023, sot unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjet administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

SUBJEKT: Z. Astrit Seferkollu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Devoll;
Z. Arban Gjoka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Malësi e Madhe;
Zj. Marsida Fani person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kuçovë;
Z. Nertil Nebiaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Gjirokastrë;
Z. Dëfrim Korbi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kukës;
Z. Erjon Lalaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kavajë;
Z. Elvis Gjika, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kamëz;
Z. Elton Sula, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Rrogozhinë;

Data: 22 Prill 2023

Nr: 395

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike”

Z. Maliq Alla, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Prrenjas;
Z. Taulant Fejzulla, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Vorë;
Zj. Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lushnjë;
Z. Artin Halili, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Pogradec;
Zj. Mariana Jorgji, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Korçë;
Zj. Dhurata Gjoka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Durrës;

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë indicie për organizimin e 24 (njëzet e katër) veprimtarive publike, nga 14 (katërmbëdhjetë) institucione publike, për të cilat pretendohet se nuk janë raportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur disa denoncime nëpërmjet provave link të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja "ç" të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Në vijim të procedurës administrative, i është kërkuar informacion personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionet shtetërore, në lidhje me veprimtaritë publike të paraportuar në ndërfaqe.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike email, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Subjektet objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

1- **Bashkia Kamëz** ka organizuar 2 (dy) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 298, 305 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 298 ID**, "*Babrru Shpat - Derë më derë, shtëpi më shtëpi, për të takuar dhe biseduar si një familje e madhe me qytetarët. Pamë nga afër bllokun e rrugëve prej 6.5 km që përfundojnë shumë shpejt dhe që përfitojnë 15.000 banorë, me standardet më të mira si më poshtë:*

Rrjetin e kanalizimeve; Ujësjellësin; Asfaltimin; Trotuaret; Ndriçimin;

Faleminderit nga zemra për mikpritjen dhe organizimin. #BashkiaQëDuam #BabrruShpati"

Prova link:

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02C6pLexKJhC6A7ykpPL4q51ëAtXbSFc7JxXczxËbmëbmiMËxAbnadVZcUJQVzPdZm2l&id=100044332874482

- Denoncimi **nr. 305 ID**, "*Ishim në Paskuqan-1, ku takuam qytetarë mirënjohës e falënderues, biseduam me ta për gjithë punët tona dhe investimin në rrugët "Josef Marksen" që ka përfunduar, "Isa Boletini" e "Haki Taho" që janë në proces. Investime me standarde që përfshijnë: Rrjetin e kanalizimeve; Ujësjellësin; Asfaltimin; Trotuaret; Ndriçimin; Si një familje e madhe me njerëzit. Faleminderit Paskuqan"*

Prova link:

<https://fb.watch/jU8sK6PBY-/>

Theksohet se këto aktivitete nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.

Më datë 17.4.2023, bashkisë Kamëz i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, dhe me datë 18.4.2023 jemi informuar se: *“Nga ana e Bashkisë Kamëz është realizuar detyrimi ligjor për raportimin e veprimtarisë në fjalë me karakter publik.*

Sa më sipër, nga ana e bashkisë Kamëz janë raportuar në ndërfaqen e raportimeve, veprimtaritë objekt denoncimi:

- *Inspektim punimesh Rruga “Josef Marksel”, Paskuqan*
- *Inspektim punimesh Rruga “Haki Taha” Paskuqan 1*
- *Inspektim punimesh Rruga “Isa Boletini” Paskuqan 1*
- *Inspektim punimesh Blloku i Rrugeve Babrru Shpat, Paskuqan.*

Përsa më sipër, nga verifikimi i të dhënave në ndërfaqen e raportimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi se bashkia Kamëz, referuar denoncimeve nr. **298 ID, 305 ID**, ka përmbushur detyrimin për raportim të parashikuar nga neni 92, i Kodit Zgjedhor, brenda afateve ligjore. Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti për këto denoncime nuk përmban elementë për konstatimin e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

2- Bashkia Kavajë ka organizuar 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 297 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 297 ID**, *“Studentët kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë krenaria jonë më e madhe! Kavaja është shquar gjithmonë për të rinjtë e saj ambiciozë që janë dalluar e kanë lënë gjurmë krenarie kudo ku kanë studiuar. Kënaqësia më e madhe e imja përveçse ti takoja vajzat tona që mësojnë në Universitetet e Tiranës dhe jo vetëm, ishte t'i dëgjoja teksa më shprehnin dëshirën e madhe që pas përfundimit të studimeve, të rikthehen në vendlindjen e tyre për të kontribuar dhe për të marr në dorë të ardhmen e Kavajës. Dhe kjo e ardhme me ju pranë, premtion shumë! #SkaKohëPërPushim #KavajaShtëpiaJonëEMadhe”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/RedjanKrali/posts/pfbid02Gm7UXnvcFGsaPËn4CëToZBD22EGAFDuDkFNQuv6qË7HZFi8mUnPk4cjfDoiPJqu7I>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Më datë 17.4.2023, bashkisë Kavajë, i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, ku jemi informuar se: *“...ky aktivitet nuk organizohet nga ana jonë. Jemi thjeshtë pjesëmarrës dhe të ftuar, nuk kemi raportuar sepse nuk ka qenë aktivitet i organizuar nga ne. Ne nuk kemi qenë organizatorë të këtij aktiviteti duke respektuar Kodin Zgjedhor. Më poshtë ju sjell dhe dokumentin që tregon organizatorin.”*

Përsa më sipër, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe faktet, të administruara gjatë hetimit administrativ, vlerësoj se referuar nenit 92, të Kodit Zgjedhor aktiviteti është rastësor dhe nuk është organizuar nga subjekte që nuk kanë detyrimin për raportim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky detyrim i atribuohet institucioneve publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencie dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, të cilat duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik. Të ndodhur në këto kushte, duke marrë parasysh edhe tematikën e veprimtarisë, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj bashkisë Kavajë.

3- Bashkia Pogradec ka organizuar 2 (dy) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 310, 311 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 310 ID**, *"Në lagjen e ""Kodrës"" të fshatit Gështenjas ku po punojmë për të mundësuar aksesin e duhur për qarkullimin e mjeteve në këtë lagje të sipërme të fshatit dhe përmbylljen më pas të ndriçimit rrugor. Pas kësaj vijojmë me hapjen e rrugëve drejt parcelave bujqësore. Edhe kjo pjesë e fshatit tashmë është përfshirë në projektin e kanalizimeve të ujrave të përdorura, ndërsa vëmendje maksimale do të ketë edhe për 4 vitet në vazhdim. #VotollirXhakolli #numër2 #VotoPartiaSocialiste #numër2 #VetëmPërpara"*

Prova link:

<https://www.facebook.com/PSPogradec/posts/pfbid037mzmFNisg9nDuPud92LaiJ7ymYma2JokggKH35Yëci3FndV4fjhGeige2pJubËkl> "

- Denoncimi **nr. 311 ID**, *"Me Organizatën e Familjeve të Dëshmorëve në Pogradec, më të bashkuar se kurrë drejt fitores së 14 Majit. Diskutuar me ta për punët që kemi bërë këto 4 vjet dhe çfarë kemi projektuar për 4 vitet në vazhdim. Besimi i tyre na jep forcën e duhur për të çuar #MëPërpara zhvillimin e pandalshëm të Pogradecit dhe Njësave. #VotollirXhakolli #VotoPartiaSocialiste"*

Prova link:

Data: 22 Prill 2023

Nr: 395
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike”

<https://www.facebook.com/PSPogradec/posts/pfbid02ftpUT9Eh4mbY89B5fA6y7tsNJHQZF1UmdBquf8k7o5xtJMu75nvSpBa89BaBeal>

Theksohet se këto aktivitete nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.

Më datë 17.4.2023, bashkisë Pogradec i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, dhe me datë 18.4.2023 jemi informuar se: *“Dua t’iu bëj me dije se unë si raportues kam për detyrë të raportoj vetëm aktivitetet publike që organizon bashkia si institucion publik. Unë nuk mund të raportoj aktivitetet e kandidatit në fushatë z. Ilir Xhakolli i cili ka axhendën e vet politike. Për më tepër këto aktivitete janë të pasqyruara në faqen e kandidatit dhe jo në faqen e institucionit.”*

4- **Bashkia Vorë**, ka organizuar 1 (një) veprimtari publike, të **regjistruar me nr. 307 ID**, për të cilat pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 307 ID**, *“PREZË-VORË Takim me banorët e Prezës një prej njësive simbol të qytetit dhe destinacion turistik kryesor i Vorës. Në 14 Maj Vora do të korrë fitore spektakolare për Partinë Socialiste.*
#PS #Vorë #VoraPërpara”

Prova link:

<https://www.facebook.com/blerim.shera.al/posts/pfbid02CtaN3sYsqV3VPvsbUKzSmMiz5KjQ1nQku8va6PM3JR3ËyUUUxfCArkPT8aSfzQJBI>

Theksohet se këto aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Më datë 17.4.2023, bashkisë Vorë, i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, ku jemi informuar se: *“Këto aktivitete nuk janë organizuar nga institucioni i bashkisë Vorë në kuadër të veprimtarisë së tij publike. Këto janë takime private të organizuara pas orarit zyrtar të punës dhe nuk janë publikuar në faqen elektronike zyrtare të institucionit dhe as në rrjetet zyrtare sociale të institucionit. Për sa me sipër bashkia Vorë nuk ka detyrim ligjor për raportimin e tyre.”*

5- **Bashkia Devoll** ka organizuar 2 (dy) veprimtari publike, të **regjistruara me nr. 261, 262 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. **261 ID**, *“Në Arrzë, fshatin që dikur dukej i largët për shkak të rrugës që stërgjatej greminave po aq e coptuar saç ishte edhe prespektiva që jepnin pashallarët e bashkisë së asaj kohe. Këtë herë shkuam shumë më lehtë përmes rrugës së re që kemi ndërtuar si një premtim*

Data: 22 Prill 2023 Nr: 395
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike”

i mbajtur për banorët para së cilëve u zotuar vite më parë. Akoma edhe më lehtë do të shkojmë kur të gjitha prioritetet tona për Devollin e Sipërm të jetëzohen plotësisht pasi kjo vepër i hap rrugë projekteve të tjera të vazhdueshme të përmirësimit të shërbimeve. Nuk ka kohë për pushim, për #DevollinQëDuam #DevollinQëNukNdalet"

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=6158274134210556&set=pcb.6158274924210477>

- Denoncimi nr. **262 ID**, "*Mes banorëve të Hoçishtit ku bashkëbiseduam gjerë e gjatë për projekte të vjetra e të reja në sfidën tonë të madhe për t'i dhënë të gjithë vëmendjen e merituar tokës sonë. Dëgjuam me kujdes çdo banor, pritëm me dashamirësi vlerësimet ashtu si edhe sugjerimet, kritikën për punët që duhet dhe do të vazhdojnë për të çuar në nivelin e duhur jetën e komunitetit. Të vendosur për t'i shkuar deri në fund projektit tonë me devollinjtë dhe për devollinjtë! Së bashku për #DevollinQëDuam #DevollinQëNukNdalet"*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=6154476584590311&set=pcb.6154477637923539>

Theksohet se këto aktivitete nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator."

Më datë 11.4.2023, bashkisë Devoll, i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 14.4.2023 jemi informuar se: "Këto takime nuk janë veprimtari publike të organizuara nga institucioni jonë për këtë arsye nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së pasi neve si institucion nuk kemi qenë organizator i këtyre takimeve. Të dyja këto takime janë organizuar pas orarit zyrtar dhe janë veprimtari politike/elektorale të organizuara në dy fshatra të bashkisë Devoll ku është lehtësisht e dukshme që dhe organizimi i tyre është bërë në ambiente private dhe jo publike apo ambiente në varësi të bashkisë Devoll, ku sipas udhëzimit tuaj nuk raportohen në KQZ. Në zhvillimin e këtyre veprimtarive nuk ka pasur përdorim të burimeve publike, nuk ka pasur asnjë logo, apo simbole të ngjashme të institucioneve publike, nuk ka pasur pasqyrim të asnjërës prej këtyre veprimtarive në faqet zyrtare (ëeb, Facebook, etj) të bashkisë e cila mund të verifikohet lehtësisht nga ana juaj, apo të jenë publikuar në profilin zyrtar të kryetarit të bashkisë Devoll. Këto aktivitete ashtu sikurse juve keni paraqitur edhe linkun në e-mail janë të pasqyruara vetëm në profilin personal (jo zyrtar) të kryetarit të bashkisë Devoll..."

6- Bashkia Durrës ka organizuar 2 (dy) veprimtari publike, **të regjistruara me nr. 316, 317 ID**, për të cilat pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. **316 ID**, "*Me kryeministrin Edi Rama dhe qytetarë të Durrësit në shëtitoren Taulantia me mbjelljen e pemëve nisëm rrugëtimin drejt 14 majit. Vetëm përpara së bashku*

Data: 22 Prill 2023

Nr: 395
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike"

me qytetarët në rrugën tonë drejt transformimit të Durrësit në një qytet turistik evropian.
#VetëmPërpara #KurrëMëMbrapa #KrenarpërPS

Prova link:

<https://www.facebook.com/emiriana.sako/posts/pfbid0ëjsÉ1CxE2BUxQop7Zj7qDiSnJuVhaPiËFgdyvaUNX1qNaLeZAEytDFeËmnoGXDLN/>

- Denoncimi nr. **317 ID**, "Me kryeministrin Edi Rama në një takim me përfaqësues të biznesit të madh në Durrës ku diskutuam për rritjen e pagës minimale por edhe çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me tregun e punës. #TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaEArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim"

Prova link:

<https://www.facebook.com/emiriana.sako/posts/pfbid0EEemhcCqfpoBMdEexYEHËBsJEyLVbnMdtE8JuDcF3X557mPiBLpFrbEJpHSDRuXjy/>

Theksohet se këto aktivitete nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator."

Më datë 17.4.2023, bashkisë Durrës i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe ka sqaruar se: "Referuar shkresë derguar nga Ju me nr. prot. 2299, datë 31.03.2023 ku citohet nga ana juaj se për aktivitetet me karakter politike/elektorale, nuk behet raportimi në KQZ .

7- Bashkia Malësi e Madhe ka organizuar 7 (shtatë) veprimtari publike, të regjistruara me nr. **273, 274,275,276, 288, 289 dhe 291 ID**, për të cilat pretendohet si vijon:

- Denoncim nr. **273 ID** "Bajza e kulturës dhe e traditës është bashkuar me alternativën tonë sepse beson se Ne mund të bëjmë më shumë se kushdo tjetër për këtë komunitet fisnik. Grupet e punës kanë nisur punën në terren dhe premtojnë rezultat historik për Bajzën, ndërsa ne premtojmë se do të vazhdojmë më tej transformimin e lagjeve dhe fshatrave për ta stolisur siç i ka hije Bajzës së Kastratit. #EcimsëBashku"

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=1736528920082780&set=pcb.1736529210082751>

- Denoncim nr. **274 ID**, "Në Bogën Alpine grupet e punës folën qartë për fitorën e thellë në zgjedhjet e 14 majit sepse Boga e vlerëson mbështetjen dhe lehtësirat që kemi krijuar për çdo individ që investon në agroturizëm dhe turizëm duke i shërbyer rritjes ekonomike të zonës dhe promovimit të Malësisë së Madhe. Shumë punë kemi bërë por asgjë në krahasim me atë çfarë

po përgatisim të konkretizojmë gjatë këtij mandati që vjen. Duam të bëjmë më shumë për njerëzit e Bogës, Ducajve, Makajve krejt Shkrelit dhe Malësisë së Madhe #EcimsëBashku "

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=1737092713359734&set=pcb.1737093250026347>

- Denoncim nr. **275 ID**, "*Dedajt e Shkrelit janë të vendosur të çojnë përpara projektet dhe angazhimin tonë për transformimin e Dedajve, Zagorës dhe Lohes. Disa ndërhyrje të rëndësishme në infrastrukturë dhe arsim kanë përfunduar, të tjera janë në proces. "*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=1737628646639474&set=pcb.1737629499972722>

- Denoncim nr. **276 ID**, "*Nga Gruemira bujare grupet e punës dhe mbështetësit tanë janë angazhuar fuqishëm që ne së bashku të vazhdojmë punët e nisura dhe projektet e reja që kemi për komunitetin e Gruemirës. Jam i privilegjuar dhe ndihem mirënjohës për secilin nga JU dhe premtoj se do e shpërblej me punë dhe me gadishmëri mbështetjen tuaj të pakursyer. #EcimsëBashku"*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=1738158913253114&set=pcb.1738159556586383>

- Denoncimi nr. **288 ID**, "*Në Razmen Turistike pata kënaqësinë të takoja të rinjtë e fshatit Vrith dhe sipërmarrës në fushën e turizmit. Vendi ynë ka fatin të ketë resurse të jashtëzakonshme natyrore, prandaj i ftova të rinjtë të shikojnë potencialin që vendi ynë AL ofron, duke aplikuar me projekte serioze për grante që vijnë nga qeveria shqiptare, institucionet europiane dhe grupet financiare ndërkombëtare në fushën e agroturizmit, sipërmarrjeve bujqësore, blegtorale, bizneset inovative etj. Do të vazhdojmë të jemi partnerë dhe mbështetës të çdo individi që ka një ide për të investuar në turizëm. Duam të jemi të parët në rajon për turizmin malor dhe për këtë na duhet kreativiteti dhe energjia e të rinjve. Bashkë bëjmë shumë"*

Prova link:

<https://www.facebook.com/toni.malesia/posts/pfbid0Tm1VXZbGSpvBtMbQf35nNUaXBry9mJtkXePËVt8oLVa36YaYGvPQqh7cvHYTVZdCl>

- Denoncimi nr. **289 ID**, "*Një takim frytdhënës me Organizatën e menaxhimit të Peshkimit, ku ndamë së bashku lajmin e mirë të firmosjes së marrëveshjes për Partneritet Strategjik, ndërmjet Bashkisë dhe Organizatës. Duke bashkëpunuar së bashku në rrugë institucionale mund të bëjmë shumë më shumë për të gjithë peshkatarët e bashkisë sonë të cilët japin një*

kontribut të çmuar në ekonominë familjare dhe të zonës. Falenderoj z.Gzim Lezaj kryetar i organizatës për menaxhimin e peshkimit dhe z.Arjan Çinari drejtor ekzekutiv, për bashkëpunimin dhe jam i bindur që së bashku do t'i japim jetë një projekti që zhvillon, modernizon dhe mbështet fuqimisht punën dhe ekonominë e peshkatarëve tanë.

Prova link:

<https://www.facebook.com/toni.malesia/posts/pfbid0dLEX9AJa7psrdxcz1bKKGëËFdsA5UKtdËb9j3AxëZ1QLLcA2ENJ1tJCEVP543kSDI>

- Denoncimi nr. **291 ID**, "Balshajt besojnë tek alternativa dhe vizioni që kemi ne për këtë perlë të bukur liqenore. Me grupin e punës biseduam për prioritetin që i kemi dhënë turizmit përmes investimeve në infrastrukturë dhe sot Balshajt janë kthyer në një destinacion të preferuar nga shumë vizitorë vendas dhe të huaj. Projekte të tjera janë gati për t'u zbatuar në agroturizëm, bujqësi dhe blegtori, përmes së cilave synojmë rritjen ekonomike për çdo familje. Me 14 maj fitojnë Balshajt dhe krejt Malësia. #EcimsëBashku"

Prova link:

<https://www.facebook.com/toni.malesia/posts/pfbid0MdrieVCBPcPKHPJAKFTtHr6rtA93RdTEBËtGZGqHëj2Gur8NCmHDMëhxHzB4h2Hel>

Më datë 11.4.2023 dhe 17.4.2023, bashkisë Malësi e Madhe i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe me shkresat nr. 91/34 prot., datë 11.4.2023 dhe nr. 91/35 prot., datë 18.4.2023, duke sqaruar se: "Ju informojmë se veprimtaritë e zhvilluara dhe të raportuara pranë KQZ nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara(KRIIK), nuk janë organizuar nga Bashkia Malësi e Madhe duke qenë në këto kushte në zbatim Ligjit 10019, datë 28.12.2008 të "Kodit Zgjedhor" në RSH i ndryshuar dhe Vendimit Nr 9 të Komisionit Rregullator", ne si Institucion nuk kemi detyrim të deklarojmë aktivitete që nuk organizohen nga bashkia Malësi e Madhe. Nga informacioni që kemi këto aktivitete kanë qenë politike dhe të organizuara jashtë orarit zyrtar me struktura politike dhe janë të publikuar ne adresen e facebook personal të z. Tonin Marinaj. Bashkia Malësi e Madhe, Kryetari z.Tonin Marinaj dhe çdo strukturë apo institucion varësie janë të predispozuar të zbatojnë rregullat dhe detyrimet që na ngarkon ligji. Duke qenë në këto kushte kërkojmë mosfillimin e procedimit administrativ për mosdeklarim aktiviteteve.

- 8- **Bashkia Rrogzhinë** ka organizuar 1 (një) veprimtari publike, të regjistruara me nr. **313 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:
- **Denoncimi nr. 313 ID** "Në Gosë për të takuar banorët e zonës dhe për të diskutuar për arritjet e sfidat që na presin përpara.#PërRrogzhinënTonë #KurrëMëMbrapa# VetëmPërpara #14Maj #EdisonMemolla Etjen Xhafaj"

Prova link:

Data: 22 Prill 2023 Nr: 395
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për raportimin e veprimtarive publike”

<https://www.facebook.com/edison.memolla.al/posts/pfbid0EYTs4GkG4ZQ3naR723mvr7fNgzeeQËUGuooN4EbQdGLnBStL2bzB2TmmZF2N7idl>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Më datë 17.4.2023, bashkisë Rrogzhinë, i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, jemi informuar nëpërmjet shkresës nr. 1548 prot. më datë 18.4.2023 ku shprehet se: *“Me datë 13.04.2023 ora 10:00, kryetari i bashkisë Rrogzhinë Z. Edison Memolla bashkë me të deleguarin politik të Partisë Socialiste Z.Etjen Xhafaj, kanë zhvilluar një takim të organizuar nga struktura lokale e Partisë Socialiste Gose me pjesëmarrës simpatizantë të Partisë Socialiste në këtë njësi. Organizator i këtij takimi është subjekti politik Partia Socialiste dhe si e tillë nuk është raportuar si aktivitet në faqen zyrtare të KQZ, pra Bashkia Rrogzhinë nuk është organizatore dhe nuk jemi në kushtet e shkeljeve të udhëzimeve për këtë aktivitet.”*

9- Bashkia Prrenjas, ka organizuar 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me nr. 312 ID, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. **312 ID**, *"Qukës-Shkumbin me skuadrën e #PS do të vijojmë me të njëjtin ritëm të organizuar dhe me bindje në fitore! #VetëmPërpara #KurrëMëMbrapa"*

Prova link:

<https://www.facebook.com/n.belba/posts/pfbid025xuE6Tdo8tPCX42aCrif2baoëmfEbXL5qjAHhDq5PTjbdye79ËY8ëPL5zBeHËEvLI>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Më datë 17.4.2023, bashkisë Prrenjas, i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe jemi informuar se: *“Aktiviteti objekt denoncimi nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së pasi referuar nenit 92 të Kodit Zgjedhor, si dhe të Vendimit nr. 9, dt. 24.12.2020, ky aktivitet nuk përbën veprimtari publike.*

Bashkia ka detyrim që të raportoj në KQZ vetëm aktivitete publike ku bashkia është organizatore dhe jo aktivitete politike ku kryetari merr pjesë si kandidat-figurë politike. Kandidati mund të pasqyrojë pjesëmarrjen në rrjete sociale private që përdor për fushatë, por jo në faqen zyrtare të bashkisë. Kryetari i bashkisë ndjek agjendën e tij si kandidat dhe figurë politike dhe kjo agjendë nuk përfshihet në raportimet e aktiviteteve të bashkisë, sipas Kodit Zgjedhor. Kjo veprimtari është pasqyruar vetëm në faqen personale të rrjetit social të Kryetarit të Bashkisë dhe jo në faqen zyrtare apo në rrjetin social të Institucionit të Bashkisë Prrenjas.”

10- Bashkia Gjirokastrë ka organizuar 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me nr. 293 ID, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. 293 ID, *“Shija që mbetet nga takimet e mira si ai që pata në Zhulat, s’trëgohet me fjalë. Bashkë me Flamur Golemin, folëm gjatë me disa prej banorëve për problematika të ndryshme që ata kanë dhe përpjekjen tonë të përbashkët për t’i dhënë zgjidhje. Nuk ka asnjë dilemë për të vazhduar punët e nisura me Bashkinë që drejtohet nga Flamuri. Lajm shumë i mirë për ta është investimi që po bëjmë të rruga, për mbrojtje lumore dhe ambicien për ta finalizuar të gjithë pjesën që lidhet me rrugën Kardhiq-Delvinë. Basti ynë është puna dhe shërbimet për njerëzit, jo thjesht të fitojmë zgjedhjet. Flamur Golemi #BashkePerGjirokastrën #SkaKohePerPushim”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/psocialiste.al/posts/pfbid02RNXgfMgsqu8EYEpkLQurmsbZrbiBSGMV KqTfLSFrZQbzked9LZuNV2kkvcMn2ds7l>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator. Gjithashtu bëhet me dije se ky aktivitet është transmetuar dhe në një media.”

Më datë 17.4.2023, bashkisë Gjirokastrë, i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 19.4.2023 jemi informuar se: *“-Bashkia Gjirokastrë ka detyrimin që të raportojë vetëm aktivitete publike ku bashkia është organizatore dhe jo aktivitete politike ku kryetari i Bashkisë merr pjesë si kandidat-figure politike. Kryetari i bashkisë në kuadër të fushatës elektorale nuk ka pengesë të marrë pjesë në cdo aktivitet që organizohet nga deputete, drejtues politikë, drejtues të enteve publike apo ministrant dhe të flasi si person politik. Kryetari i bashkisë ka të drejtë të ndjekë agjendën e tij si kandidat dhe figure politike dhe kjo agjendë nuk përfshihet në raportimet e aktiviteteve të bashkisë sipas Kodit Zgjedhor. Aktiviteti në fjalë është një takim me banorë të fshatit Zhulat ku z. Flamur Golemi ka qenë i pranishëm jo në cilësinë e kryetarit të bashkisë dhe për këtë arsye nuk është raportuar as në ndërfaqen e K.Q.Z-së dhe as në faqen zyrtare të bashkisë por vetëm në rrjete sociale private.”*

11- Bashkia Kukës ka organizuar 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me nr. 296 ID, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. 296 ID, *“Fotoalbumi i takimeve me banorët e Njësisë Malzi, të cilët janë gati për votëbesimin e mandatit të dytë të Bashkisë, për fitoren e pa diskutueshme të 14 Majit, si dhe për vijimin e projekteve të mëtejshme zhvillimore të Kukësit tonë. Me 14 Maj të gjithë bashkë për njeriun e punës, për të ardhmen e Kukësit e familjeve tona! #UnëVotojPunën #UnëVotojSafetGjici #KukësiNukNdalet”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/safetgjici/posts/pfbid037mJeazGBEAnP5c8xC77chN2afogh1HjKEUqjCpNRVfmc18zxnUaqmGKËASgCRAzol>

Më datë 17.4.2023, bashkisë Kukës, i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 19.4.2023 jemi informuar se: *“Aktiviteti i publikuar në ndërfaqen e kryetarit/kandidatit, është aktivitet politik i organizuar nga subjekti partiak, në të cilën kandidon kandidati. Kryetari/kandidati në këtë rast ka ndjekur agjenden e tij si kandidat dhe figurë politike. Si e tillë kjo axhendë nuk përfshihet në raportimet e aktivitetit të bashkisë Kukës, kjo sipas Kodit Zgjedhor si dhe sipas shkresës tuaj nr.2299 prot., datë 31.03.2023.*

12- Bashkia Lushnjë ka organizuar 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 309 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 309 ID**, *“ME NJERËZIT PËR NJERËZIT! Ditë e gjatë dhe impenjative, por shumë e vlefshme në Njësinë Allkaj! Kemi bërë jo pak punë në një vit, ka ende për të bërë, dhe ky është angazhimi im; mbështetja juaj në 14 Maj do të jetë motivimi më i madh për të realizuar punët në shërbim të infrastrukturës publike e jo e vetëm, gjithnjë duke ecur VETËM PËRPARA, KURRË MË MBRAPA! #BashkëPërLushnjën”*

Prova link:

<https://www.facebook.com/eriselda.sefa1/posts/pfbid026pbJhugMPGrc7yhiEuoGjV7d7T31d3pFzf2sDEAPis9gtzBdtZ9LDHF7P1rxkfpI>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Më datë 17.4.2023, bashkisë Lushnje i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, dhe më datë 19.4.2023 jemi informuar se: *“Ky takim me banorët e njësisë Allkaj nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, sepse nuk është aktivitet/veprimtari publike e institucionit, por takim elektoral i kandidatës (kryetares aktuale) dhe deputetit z.Erion Braçe, pas prezantimit në datën 11 prill të 61 kandidatëve për kryetarë dhe hapjes të fushatës nga forca politike PS. Ky takim është zhvilluar jashtë orarit zyrtar të punës dhe është publikuar vetëm në faqen personale të zj.Eriselda Sefa.”*

13- Bashkia Korçë ka organizuar 1 (një) veprimtari publike, **të regjistruar me nr. 315 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 315 ID**, *“LAGJJA 15 Shumë entuziast nga takimi me gratë dhe vajzat e Lagjes 15 në Korçë. Faleminderit për bashkëpunimin dhe përkushtimin tuaj! Jeni mbështetja jonë më*

e madhe për të vazhduar përpara me projektet tona madhore për Korçën. #KorçaePara #bashkiakorçe"

Prova link:

<https://www.facebook.com/filosotiraq/posts/pfbid0NCëydtstghJJ9ARhniJaËCLikTpNm6bUrkBPivvYi7bY5VKGb9KjiCAtroFL4avml>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator."

Më datë 17.4.2023, bashkisë Korçë i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, dhe me datë 20.4.2023 jemi informuar se: "Bazuar në vendimin Nr.9 datë 24.12.2020, ju sqarojmë se kjo veprimtari nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së pasi ka karakter elektoral."

14- Bashkia Kuçovë ka organizuar 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me nr. **292 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:

- Denoncimi nr. **292 ID**, "Kënaqësi kur jep personalisht lajmin e mirë. Së shpejti fillon rikualifikimi urban i Lagjes 11 Shkurti. Lajmin e ndava me disa nga banorët e zonës! Me ndihmën e secilit do të vazhdojmë ta përmirësojmë qytetin gjithmonë e më shpejt".

Prova link:

<https://www.facebook.com/KreshnikHajdarii/posts/pfbid0KVMkFSo73nRVyhuE8LEUDP8gCSnyvfNb8pKKËM24cCrahNfVH9sJJjDetksn7mCl>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator."

Më datë 17.4.2023, bashkisë Kuçovë i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, dhe me datë 11.4.2023 jemi informuar se: "Këto takime janë zhvilluar në cilesinë e kandidatit të Partisë Socialiste për bashkinë e Kuçovës dhe jo në cilësinë kryetarit të Bashkisë. Nuk është përdorur ndonje infrastrukture publike apo burimi tjetër publik. Keto dy aktivitete nuk janë pasqyruar ne rrjetet sociale te Bashkise Kuçove, por ne rrjetet e mia sociale personale/private. Bazuar ne vendimi nr. 9, datë 29.01.2022, nuk kam pasur detyrim ligjor per ta raportuar keto dy aktivitete. "

Në përfundim të hetimit administrativ, pas shqyrtimit materialeve u vlerësua se natyra e aktiviteteve të kryera nga kryetarët e bashkivë të sipërcituara, janë të karakterit politik/elektoral dhe nuk janë veprimtari publike të institucionit të bashkisë. Këto aktivitete janë zhvilluar në kuadër të aktiviteteve me anëtarë dhe mbështetës të Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Kryetari i bashkisë, si funksionar i partisë ku aderon, mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete dhe të shprehë mendimet e veta.

Këto veprimtari nuk kanë detyrimin për raportim në ndërfaqen e raportimeve pasi nuk janë organizuar dhe zhvilluar nga institucioni i bashkisë.

Përsa më sipër, rezultoi se veprimtaritë objekt denoncimi të regjistruara me nr. 261 ID, 262 ID , 273 ID, 274 ID , 275 ID , 276 ID , 288 ID, 289 ID, 291 ID, 292 ID, 293 ID, 296 ID, 297 ID, 298 ID, 305 ID, 307 ID, 309 ID, 310 ID, 311 ID, 312 ID, 313 ID, 315 ID, 316 ID, 317 ID, nuk përmbajnë fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në neneve 91, dhe 92 të Kodit Zgjedhor si dhe të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për:
 - a) Z. Astrit Seferkolli, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Devoll;
 - b) Z. Taulant Fejzulla, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Malësi e Madhe;
 - c) Zj. Marsida Fani person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kuçovë;
 - d) Z. Nertil Nebiaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Gjirokastrë;
 - e) Z. Dëfrim Korbi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kukës;
 - f) Z. Erjon Lalaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kavajë;
 - g) Z. Elvis Gjika, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kamëz;
 - h) Z. Elton Sula, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Rrogozhinë;

- i) Z. Maliq Alla, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Prrenjas;
 - j) Z. Taulant Fejzulla, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Vorë;
 - k) Zj. Erisa Qalliu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lushnjë;
 - l) Z. Artin Halili, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Pogradec;
 - m) Zj. Mariana Jorgji, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Korçë;
 - n) Zj. Dhurata Gjoka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Durrës.
2. Tërheqje vëmendje për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
 3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI